



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE

LEJE INFRASTRUKTURE

Nr. 411, datë 26/04/2023

Në mbështetje të neneve 27, 29 dhe 39 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neneve 11, 14, 15, 16, 22 dhe 23 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit“ i ndryshuar, dhe pas shqyrtimit të aplikimit për “Leje infrastrukture për objektin Rikonstruksioni i rrugeve te brendshme ne njesin administrative Orikum“, dorëzuar elektronikisht më datë 26/04/2023, me numër aplikimi AN260420230050, nr. Prot 4195 Njësia Administrative _Orikum, Bashkia Vlore, dhe dokumentacionit shoqërues të kërkesës si vijon:

VENDOSA:

1. Lëshimin e kësaj lejeje infrastukture për zhvilluesin BASHKIA VLORE , NUIS/NID K567032010, të cilit/cilëve i/u lejohet ndërtimi i objektit “Rikonstruksioni i rrugeve te brendshme ne njesin administrative Orikum“, Bashkia Vlore sipas kushteve të zhvillimit që vijnë:
2. Kjo leje është e vlefshme për një periudhë 9 mujore nga data e fillimit të punimeve, referuar grafikut të punimeve.
3. Afati i fillimit të punimeve është deri në 1 (një) vit nga data e lëshimit të kësaj lejeje. Kjo leje është e pavlefshme nëse zhvilluesi nuk fillon punimet e ndërtimit brenda afatit një vjeçar pas lëshimit të saj, bazuar në nenin 40 të ligjit nr.107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.
4. Nëse ndërtimi ka filluar pas kalimit të afatit njëvjeçar apo vijon edhe pas përfundimit të afatit të përfundimit të punimeve, punimet konsiderohen të paligjshme.
5. Në rast shkelje të kushteve të kësaj leje do të merren masa në përputhje me ligjin, deri në prishje të punimeve të kryera. Zhvilluesi, zbatuesi dhe mbikqyrësi i punimeve janë përgjegjës solidarisht në rast kryerje punimesh në shkelje të kësaj lejeje apo të ligjeve që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.
6. Zhvilluesi është i detyruar që të njoftojë nëpërmjet sistemit e-leje, bashkinë për fillimin e punimeve si dhe të komunikojë emrat e zbatuesit, mbikqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve, së bashku me licensat profesionale përkatëse. Në mungesë, punimet konsiderohen të paligjshme.
7. Zhvilluesi është i detyruar që, pas përfundimit të ndërtimit dhe përpara përdorimit të tij, të kërkojë nëpërmjet aplikimit elektronik e-leje nga bashkia që të pajiset me çertifikatën e përdorimit të tij.
8. Kundër kësaj lejeje, zhvilluesi mund të paraqesë ankim brenda 15 ditëve nga data e marrjes njoftim

Drejtues. Zambak Selmani

KRYETARI I BASHKISË

Dritan LELI